

VENDIM
Nr.17, datë 16.7.2007

**PËR SKEMËN E SHTYRJES SË PAGESËS SË TVSH-SË MAKINERIVE DHE PAJISJEVE
TË IMPORTUARA, SI DHE TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË IMPORTUAR NGA KESH
SHA**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

Z. Genc Ruli	- Kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	- Anëtare
Znj. Mimoza Vokshi	- Anëtare
Z. Viktor Gumi	- Anëtar
Z. Ledi Bianku	- Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.7.2007, shqyrtoi raportin “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.”. Njoftimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Financave me shkresën nr.3927, datë 28.5.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.5, datë 28.5.2007.

BAZA LIGJORE: Si bazë për dhënien e ndihmës është neni 4 i projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar””.

OBJEKTIVI/VAT: Skema synon të lehtësojë biznesin që kërkon të investojë, duke i dhënë një kohë të mjaftueshme për vënien në shfrytëzim të makinerive dhe pajisjeve dhe shlyerjen e mëtejshme të pagesës së TVSH-së, si dhe të krijojë mundësinë për KESH sh.a.-në, për të përballuar importin e energjisë, në kushtet e vështirësive të sektorit.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Plani për dhënien e ndihmës përbëhet nga dy komponentë:
 - a) skemë e ndihmës shtetërore, që ka të bëjë me shtyrjen e pagesës së TVSH-së, për importimin e makinerive dhe pajisjeve, si dhe
 - b) ndihmë individuale, që ka të bëjë me shtyrjen e pagesës së TVSH-së, për importimin e energjisë elektrike nga KESH sh.a.-ja”.
2. Për sa i takon komponentit të parë skema, në parim, e shtrin veprimin në të gjitha furnizimet për makineri e pajisje, pa bërë dallim midis sektorëve apo fushave të veprimtarisë. Megjithatë, ajo ka karakter përzgjedhës, pasi efektet e saj janë të lidhura me investimet dhe jo me furnizimin e drejtpërdrejtë të mallrave apo shërbimeve.
3. Skema aplikohet vetëm për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, gjë që synon në disiplinimin e regjistrimit të subjekteve dhe uljen e informalitetit. Intensiteti i ndihmës që mund të përfitohet gjatë zbatimit të skemës llogaritet në 3,6% dhe është brenda kufirit të lejuar.
4. Skema synon të nxisë investimet, nëpërmjet futjes së teknologjive të reja, të cilat do të çojnë në rritjen e efikasitetit ekonomike, por edhe të aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve shqiptare.
5. Nuk është dhënë kohëzgjatja e skemës në vite.
6. Për sa i takon komponentit të dytë, ai synon të mbështesë KESH sh.a.-në, si prodhuesi kryesor i energjisë në vend për mosbllokimin e likuiditeteve të nevojshme për importin e energjisë elektrike. Sektori i energjisë elektrike, po kalon vështirësitë e një krize energjetike të tejzgatur dhe ka nevojë për mbështetje për kthimin e tij në normalitet.
7. Skema nuk ka parashikuar mekanizmin e raportimit të zbatimit të saj dhe as kushtet kumulative që duhet të plotësojnë ndërmarrjet, nëse ato mbështeten nga forma të tjera të mundshme të ndihmës shtetërore.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 13 pika 3, neni 14 pika 1 dhe nenit 22 pika 2 të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”,

VENDOSI:

1. Plan i për dhënien e ndihmës nëpërmjet nenit 4 të projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndahet në dy akte normative të veçanta:

a) Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së së makinerive dhe pajisjeve të importuara, që funksionon si skemë e ndihmës shtetërore;

b) Për shtyrjen e pagesës së TVSH-së së energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.-ja, që funksionon si ndihmë shtetërore individuale.

2. Ministria e Financave të përcaktojë kohëzgjatjen e skemës së ndihmës për shtyrjen e pagesës së TVSH-së së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe kohëzgjatjen e ndihmës individuale për shtyrjen e pagesës së TVSH-së së energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.

3. Ndërmarrjet përfituese në kuadër të skemës, ose në kuadër të ndihmës individuale do të duhet të deklarojnë çdo formë tjetër ndihme, që kanë përfituar ose përfitojnë nga Ministria e Financave ose nga dhënës të tjerë të ndihmës.

4. Ministria e Financave (ose institucioni i autorizuar prej saj si zbatues i skemës) duhet të raportojë deri më datë 31 mars të çdo viti, pranë DNSH-së për zbatimin e skemës gjatë vitit paraardhës financiar, si dhe të ruajë të gjitha të dhënat për ndërmarrjet përfituese në kuadër të skemës, për një periudhë prej 10 vjetësh, pasi është dhënë ndihma e fundit individuale.

5. Planet për dhënien e ndihmës, sipas ndarjes së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të hyjnë në zbatim, pasi të jenë përmbushur kushtet e dhëna në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli